



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.374/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sadaj- Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Artan Mezraja, kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Kaçanik, me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, pa autorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në seancën e panelit, të mbajtur me datë 14.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa Anr.374/2021 e datës 12.02.2021, paraqitur nga Artan Mezraja, kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Kaçanik, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Kaçanik.

A r s y e t i m

Me datë 12.02.2021 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Artan Mezraja, kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Kaçanik, me të cilën thekson se me datën 08.02.2021 nga Policia e Kosovës – Stacioni Kaçanik ka pranuar një Raport të Monitorimit të Tubimit Publik të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Kaçanik, ku ky subjekt politik ka organizuar tubim elektorale pa e përfillur nenin 7 të Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike dhe si i tillë ky tubim mund të cilësohet i pa autorizuar. Parashtruesi i ankesës thekson se tubimi është mbajtur në kafiterinë “Inexi” në Kaçanik, me datë 06.02.2021 nga ora 12:00 – 12:45, ku pjesëmarrës në tubim ishin mbi 100 - 150 persona, ndër ta edhe kryetari i këtij subjekti politik Ramush Haradinaj.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur Raportin e monitorimit të tubimit politik nr.serik 02 të datës 08.02.2021 paraqitur nga stacioni policor Kaçanik dhe dy foto të printuara.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK lidhur me ankesën e paraqitur nga Artan Mezraja Kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor në Kaçanik, duke kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 12.02.2021 në ora 18:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e paraqitur nga

Artan Mezraja, Kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor në Kaçanik me pretendimet se ankesa është e pasafatshme pasi që shkelja e pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë 06.02.2021 ndërsa ankesa është dorëzuar përmes postës me datë 10.02.2021, afat ky që bie në kundërshtim me nenin 5 par.5.5 të Rregullës 02/2015. Prandaj sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë nga momenti i shkeljes kur ka ndodhur shkelja e pretenduar e deri në momentin e ushtrimit të ankesës kanë kaluar më shumë se 24 orë, përkatësisht kanë kaluar 4 ditë e po ashtu nga raporti i Policisë së Kosovës për monitorimin e tubimit politik me nr.serik 02 të datës 08.02.2021, vërtetohet se ky raport është paraqitur me datë 08.02.2021 ndërsa tubimi nga subjekti politik AAK është mbajtur me datë 06.02.2021.

Në fund parashtruesi i përgjigjes në ankesë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK i ka propozuar PZAP-it që ankesën A.nr.374/2021 të datës 10.02.2021 ta hudhë poshtë si të pasafatshme dhe të pabazuar pasi që nuk qëndrojnë pretendimet se është shkelur neni 7 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Nga ankesa e paraqitur nga Artan Mezraja, kryesues i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Kaçanik, e cila është pranuar në PZAP përmes postës me datë 12.02.2021 konstatohet se ankesa është paraqitur në datën kur është vulosur nga posta ashtu siç përcaktohet në nenin 5.2 të Rregullës Nr. 02/2015, Rregullat dhe Procedurat e që është data 10.02.2021.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5, paragrafi 5, i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it, brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar”*. Në këtë rast ankesa është paraqitur në PZAP me datë 12.02.2021 në ora 11:14 derisa shkelja e pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë 06.02.2021. Përkundër faktit se shkelja është lajmëruar nga Policia e Kosovës me raport policor me datë 08.02.2021, KKZ Kaçanik ankesën e ka adresuar në PZAP me datë 10.02.2021, përmes postës duke lëshuar kështu afatin e përcaktuar ligjor të cekur si më lartë.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr.374/2021 me datë 14.02.2021

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.

